

# MADHËSHTIA E VAÇE ZELES NË SKENËN E BAZELIT

Se në mërgatën tonë janë pjekur kushtet edhe për prezantime e organizime madhështore, sidomos kur ka të bëjë me emra të shquar të kulturës sonë kombëtare, këtë e dëshmoi mbrëmja në qytetin me traditë 500 -vjeçare universitare, ku emri dhe vepra e Vaçes shkëlqeu edhe njëherë, duke tubuar edhe disa nga yjet tona muzikore.



## „LARG DHE PRANË NJERËZVE“

ALBUMI QË PARAQET, GJITHÇKA QË VAÇE ZELA E KA REGJISTRUAR NË RADIO TIRANË ME TITULL „LARG DHE PRANË NJERËZVE“, KU JANË 56 KËNGË, ASHTU SIÇ JANË REGJISTRUAR PËR HERË TË PARË QË PREJ FILLIMIT TË KARRIERËS NË VITET „60-TA E DERI NË FESTIVALIN E FUNDIT NË RTSH, I U DHURUA TË PRANISHMËVE NË KËTË MBREMJE NË BAZEL. ALBUMI ËSHTË PËRGATITUR NGA MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE NË NJË EDICION TË VEÇANTË MUZIKOR ME RASTIN E „VITIT 2009 - VITI VAÇE ZELA“, QË PËRKOI ME 70-VJETORIN E KËNGËTARES.

## KITARA E VAÇES

AKTORJA LIRI LUSHI, PASI PËRMENDI SE VAÇJA TASHMË ËSHTË KTHYER NË NJË GOJËDHËNË E KTHYER NË MITOLOGJË, LEXOI POEZI PËR TË NGA AUTOR TË NDRYSHËM, SI DHE NJË SHKRIM KU FLITEJ SE SI VAÇJA I DHUROI NJË TË BURGOSURI POLITIK, GËZIM ÇELËS, KITARËN E SAJ DHE SE SI AJO KITARË PËR 22 VJET U BART NË BURGJET E TIRANËS E SPACIT, DERISA RA DIKTATURA KOMUNISTE. PO KJO KITARË QË U RUAJT ME AQ DASHURI NGA TË BURGOSURIT ISHTË EDHE NJË NGA „USHQIMET SHPIRTËRORE“, POR EDHE FRYMËZIM STOICIZMI E QËNDRESE. TINGUJT E KITARËS SË VAÇES EDHE NË BURG MBAJTËN GJALLË SHPRESEN E MBIJETESËS.

## DIVA E ULUR NË FRONIN 400 VJEÇAR

Me siguri se të gjitha epitetet e deri tashme e edhe ato që u thënë në mbrëmjen mbresëlënëse muzikore kushtuar artistes sonë, **Vaçe Zela**, nuk do të mund ta thonë tërë atë që paraqet kjo figurë madhore e kulturës shqiptare. Madhësinë dhe ngjitjen e saj në pedestalin që meriton, sikur e përmbushi simbolikisht një fron (ulëse) me lashtësi 400 e sa vjeçare, por edhe artistët dhe mysafirët që e rrethonin. E tërë mrekullia kulturore ndodhi më 23 maj, në një nga godinat reprezentative të Bazelit në Zvicër, në Schützenhaus, ku u mbajt një mbrëmje e titulluar “Vaçe Zela larg dhe pranë njerëzve”, e organizuar me nismën e Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë, zotit **Ferdinand Xhaferaj** dhe e ndihmuar e përkrahur nga Lidhja Shqiptare në Botë dhe Këshillimorja Shqiptare në Bazel. Mbrëmja kishte tubuar personalitete të shquara të artit e kulturës shqiptare, të korit diplomatik nga Shqipëria e Kosova në Zvicër, por edhe miq e dashamirë të divës sonë Vaçe Zelës.

## E NDERUAR PËR SË GJALLI ME URDRIN “NDERI I KOMBIT”

Në emër të organizatorit manifestimin e hapi **Nazmi Jakurti**, i cili theksoi se nuk mund të flitet për kolosët e kulturës shqiptare pa u përkulur para këtij emri të madh, që për



kontributin e veçantë dhënë muzikës, artit e kulturës shqiptare dhe asaj botërore u nderua me çmimet dhe mirënjohjet më të larta kombëtare e ndërkombëtare. Kësaj salle të lashtë, që gjatë shekujve, ka pritur personalitete të shquara arti, kësaj radhe po i shtohet edhe një kapitull i çmueshëm, ai mbi Vaçe Zelën. Më pastaj fjalën e mori drejtuesja e këtij programi, gazetaria e BBC-së në Londër, **Mirela Shtembari**, e cila nënvizoi se sonte jemi mbledhur për t'i kushtuar këtë mbrëmje të madhërishtme Vaçe Zeles, gjigantes së skenës shqiptare, artistes së madhe. Përkujtoi se, Vaçja është e vetmja grua shqiptare e nderuar për së gjalli me urdhrin “**Nderi i Kombit**”. Në sallë sakaq emocione rrëqethëse përmes një video solli zëri i mrekullueshëm i Vaçe Zelës, me këngën “*Erë pranverore*”, ashtu siç ka kënduar në festivalin e parë në radio.

## NË MENDJEN DHE ZEMRËN E GJITHË



## SHQIPTARËVE

Duke përshëndetur në emër të qeverisë shqiptare, zëvendësmministria e kulturës, Suzana Turku, lexoi edhe një letër të kryeministrit **Sali Berisha** drejtuar Vaçes, ku ndër të tjera thuhet: “*E dashura Vaçe, ti je e do të mbetesh përherë në mendjen dhe zemrën e gjithë shqiptarëve. Përsëritet edhe gjithë shqiptarët që janë mbledhur rreth teje. Të përqafoj nga larg. Sali Berisha.*” Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, **Prof. Gudar Beqiraj**, dorëzoi Vaçes një mirënjohje në emër

të Akademisë, për “Zërin e saj të shekullit”, ndërkaq **Mehmet Elezi**, ambasador i Shqipërisë në Bernë, evokoi ca kujtime nga jeta studentore, kur si studentë shitnin e edhe bonin e darkës për të shikuar edhe për të dytën apo të tretën herë koncertet e Vaçes. Ai shtoi se rrezatimit magjik të Vaçes i ka kontribuar kujdesi i jashtëzakonshëm familjar nga bashkëshorti i saj, **Pjetri** dhe vajza **Irma**. Ai përgëzoi organizatorët për një organizim kaq të mrekullueshëm. **Dikur këngët e Vaçes në Kosovë “mollë e ndaluar”**





**STËRNIPI SKËNDERBEUT**  
E VEÇANTA E KËSAJ MBRËMJEJE ISHTE EDHE PJESEMARRJA E AKTORIT ITALIAN, ALESSANDRO CASTRIOTA SCANDERBEG, E NJËKOHËSISHT STËRNIPI TË BREZIT TË 14 TË HEROIT TONË KOMBËTAR, GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU. AKTOR, PIANIST E KËNGËTAR XHAZI, ALESSANDRO CASTRIOTA SCANDERBEGA INTERPRETUAR ME KOMPANI TË NDRYSHME, NDËR TË CILAT EDHE ME TEATRIN DHE OPEREN E ROMËS NË QYTETET MË TË MËDHA ITALIANE. NJË NDRË ROLET MË TË SPIKATURA TË TIJ ËSHËTË AI I VIRGILIOS NË "KOMEDINË HYJNORE" TË DANTE ALIGERIT, QË VITIN E KALUAR U CILËSUA EDHE NGJARJE ARTISTIKE E VITIT PËR ITALINË. NDRËKQA, NË MBRËMJEJEN E BAZELIT AI KËNDOI KËNGËN ARBERËSHE "MALL PËR ATDHENË", DUKE U PËRCJELL ME DUARTROKITJE TË GJATA NGA TË PRANISHMIT.



ku e presin obligimet e shumta. Këngëtarja **Mimoza Selimi** që jeton në Zvicër që nga viti 2005, këndoi një këngë kushtuar ish- mësueses së saj Vaçe Zelës. Më pastaj vazhdoi dalja e njëpasnjëshme e artistëve nga Shqipëria, duke filluar nga më i riu, **Dilan Reka, Hysni Zela** (vëllai i Vaçes i shoqëruar me kitarë nga **Genc Dashi**, piano **Gjon Guralumi e Dania Bytyqi**), **Elina Duni, Mimoza Nazarako** e të tjerë. Në këtë mbrëmje të mrekullueshme e vetmja mangësi, hqi disa defekteve teknike, ishte muqesa e ndonjë artisti nga Kosova apo viset tjera etnike jashtë Shqipërisë. Shkaqet dhe arsyet për këtë mungesë nuk arritëm t'i mësojmë as nga vetë organizatori, por nuk dëshirojmë të mendojmë se mos kanë munguar ftesat apo mosinteresimi. Manifestimi filloi me muzikë e përfundoi me një buqetë të madhe lulësh për Vaçen nga drejtori i këshillimores së Bazelit, **Skender Nikoliqi** pasi që këngëtarja jonë krahas dashurisë për këngën ushqen edhe një pasion e dashuri për lulet. Krejt në fund mund të konstatojmë edhe njëherë se mërgata jonë po jep provime pjekurie edhe në organizimet e tilla siç ishte edhe ky në qytetin e Bazelit.

Rexhep Rifati



**PIKA MAHNITËSE TË ARTISTËVE KULMORË**

Krahas përshëndetjeve vazhdoi edhe pjesa artistike që e bëri këtë mbrëmje edhe më të madhërishme. Një nga yjet e rinj të skenës lirike, tenori i shquar shqiptar, **Saimir Pirgu**, kishte ardhur me nguti nga Londra, sa për të kënduar me zërin e tij të mrekullueshëm duke u përlulur para Vaçe Zeles, duke e cilësuar atë, jo vetëm si një këngëtare të pakapërcyeshme, por si një artiste të madhe prapa së cilës qëndron thjeshtësia dhe afërsia njerëzore. Me t'u përshëndetur Saimiri, lëshoi me nguti sallën për t'u kthyer në Londër

Ambasadori i Kosovës në Bernë, **Naim Malaj**, përmendi se fjalët janë të mangëta për zërin e papërsëritshëm të Vaçe Zelës dhe përkujtoi se shqiptarët në Kosovë dënoheshin edhe nëse kishin dëgjuar këngët e Vaçes. Porse shtoi se tash gjendja ka ndryshuar dhe se ky shekull mund të quhet shekull i shqiptarëve, i dhuroi Vaçes figurën e "Hyjneshës në fron".

Një mirënjohje në emër të Lidhjes së Shqiptarëve në Botë, Vaçe ia dorëzoi edhe **Simon Kuzhni**, kryetar i kësaj lidhjeje, i cili tha se në Kosovë në vitet e hershme edhe këngët e Vaçes paraqisnin një "mollë të ndaluar". Porse megjithatë në një familje prizrenase mblidheshin të rinjtë dhe dëgjonin zërin e saj të mrekullueshëm përmes një radioje. Në manifestim përshëndetën edhe personalitete që ishin të pranishëm, në mes të tyre edhe **Bardhyl Londo**, poet e këshilltar në Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë.

**NJË YLL QË DO TË SHKËLQEJË PËRJETËSISHT**

Një letër kushtuar artistes dhe mikeshës së saj e lexoi edhe **Edlira Dedja**, e cila ndër të tjetra shkruante se: "Ti e dashura Vaçe do të mbetesh fenomeni i këngës shqipe, një yll që do të shkëlqej përjetësisht në qiellin e historisë së saj. Karriera jote, edhe pse u mbyll brenda



**DOKTORATURA E TRETË SHQIPTARE**

**Eksperti i ri 34- vjeçar me prejardhje nga Peja, Alban Y. Neziri, sapo mbrojti me sukses të shkëlqyeshëm në Universitetin e Bernës një temë doktorature, ndërsa në korrik pret të mbrojë edhe doktoraturën e dytë në Universitetin Mjekësor të Gracit në Austri.- Një muaj më parë në Lozanë ka doktoruar Igli Tashi në ekonomi dhe Dr. des. Luljeta Shaqiri-Emini, në psikologji në Universitetin e Cyrihut.**

**Nga Rexhep Rifati, Bernë**

Disa nga shqiptarët e rinj në Zvicër po arrin rezultate të brilante edhe në fushën e shkencës. Fakti se vetëm brenda dy muajsh në Zvicër kanë mbrojtur temat e doktoraturës tre ekspert të ri: **Dr. Igli Tashi** (me prejardhje nga Shqipëria) në fushën e ekonomisë në Universitetin e Lozanës (në gjuhën frenge), **Dr. des. Luljeta Shaqiri-Emini** (Kosova Lindore) në psikologji në Universitetin e Cyrihut (në gjuhën gjermane) dhe tash më 21 maj në Universitetin e Bernës, **Alban Y. Neziri** (Kosova) në fushën e mjekësisë në gjuhën angleze. Për të gjithë ata që patën rastin e sidomos për prindërit e ardhur nga Kosova ishte kënaqësi e veçantë të shihnin se si i biri i tyre Albani mbronte temën e doktoraturës para një komisioni prestigjioz ndërkombëtar. Për të përcjell këtë akt solemn kishin ardhur pos miqve e të afërme të Alban Y. Nezirit edhe ambasadori i Shqipërisë Mehmet Elezi dhe sekretarja e parë e ambasadës së Kosovës, Artana Bardhi. Titulli i tezës së doktoratës së Alban Y. Nezirit: "Matjet e avancuara kuantitative sensorike dhe elektrofiziologjike të dhembjes te pacientët me dhembje kronike", ndërsa titulli i fituar akademik: **Doktor i Shkencave dhe Inxhinierisë Biomjekësore**. Mentor i parë: Prof. dr. Michele Curatolo, udhëheqës i klinikës së terapisë së dhembjes në spitalin universitar dhe profesor i anesteziës në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Bernës. Mentor 2: Prof. dr. Lars Arendt-Nielsen, Qendra e Hulumtimit të Interakcionit

Sensorik-Motorik, Universiteti i Aalborgut, Danimarkë dhe Mentor 3: Prof. dr. Ole K. Andersen, Qendra e Hulumtimit të Interakcionit Sensorik-Motorik, Universiteti i Aalborgut, Danimarkë.

Komisioni përbëhej nga Kryetari: Prof. dr. med. Thomas Graven-Nielsen, Qendra e Hulumtimit të Interakcionit Sensorik-Motorik, Universiteti i Aalborgut, Danimarkë; Prof. dr. med. Mariano Serrao, Neurolog dhe Otolog, Universiteti i Romës, Itali; Prof. dr. med. Jules Desmeules, Spitali Universitar i Gjenevës dhe moderatori: Ass. Prof. dr. Kelun Wang, Qendra e Hulumtimit të Interakcionit Sensorik-Motorik, Universiteti i Aalborgut, Danimarkë.

Teza e Doktoratës, e cila i përket fushës së hulumtimit të dhimbjes në shkencat e neurologjisë, është bazuar në punën shkencore 4-vjeçare të Dr. med. Univ. Alban Y. Nezirit në Departamentin e Anestezisë të Spitalit Universitar Inselspital të Bernës (ku edhe Albani mbrojti temën), në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën e Interakcionit Sensorik-Motorik të Universitetit të Aalborgut të Danimarkës. Gjatë katër viteve hulumtuese-shkencore, punimet e tij janë shpërblyer dy herë, si punimet më të mira shkencore në kongreset ndërkombëtare për anesteziën dhe dhembjen.

Teza e Doktoratës është bazuar në 4 punime shkencore, dy të botuara dhe dy të tjera që gjenden në shtyp. Në punimin e parë është zhvilluar një metodë e re për matjen dhe kuantifikimin e fushave receptive të reflekseve të perceptimit të dhimbjes. Kjo metodë mundëson për herë të



KRYETARI I KOMISIONIT, PROF. DR. MED. THOMAS GRAVEN-NIELSEN, SHPALL SIMBOLIKISHT ALBAN Y. NEZIRIN DOKTOR SHKENCE.



parë matjen objektive të fushave të reflekseve spinale dhe paraqitjen e tyre në mënyrë vizuale. Në punimin e dytë dhe të tretë shkencor janë përcaktuar vlerat referente të matjeve elektrofiziologjike (matjeve objektive) dhe psikofizike (matjeve subjektive) të perceptimit të dhembjes, duke përdorur modele të ndryshme të stimulimit dhe mjete të avancuara për regjistrimin e tyre. Njëkohësisht është analizuar ndikimi i faktorëve demografikë, psikologjikë dhe shëndetësorë në matjet e avancuara të perceptimit të dhembjes. Në punimin e katërt janë testuar 20 paciente me endometriozë të diagnostifikuar, i cili është një tumor i endometriut (mitrës) që shkakton dhembje kronike. Te këto paciente është diagnostifikuar me sukses tejdjeshmëria e sistemit nervor qendror, si mekanizëm i kronifikimit të dhembjes, duke përdorur metodën e re për përcaktimin e fushave receptive të reflekseve spinale, të zhvilluar në punimin e parë shkencor. Në fund komisioni vlerësoi me **suma cum Laude** (shkëlqyeshëm) mbrojtjen e temës nga ana e Alban Y. Neziri, ndërsa që profesori i tij Michele Curatolo, udhëheqës i Departamentit të terapisë së Dhembjes e shpërbleu atë me një dhuratë simbolike. Aktualisht Alban Y. Neziri është bashkëpunëtor Shkencor (nga 1 mars

2006) në Departamentin Universitar të Anestezionit dhe Terapisë së Dhimbjes në Inselspital, Spitali Universitar i Bernës në dhe shquhet si bashkëpunëtor shkencor (1.10.2007 – 30.09.2008) në Center for Sensory-Motor Interaction, University of Aalborg Denmark. Albani prej tetorit 2007 është edhe kandidat për Dr. Sci. Med. në Universitetin Mjekësor të Gracit, me temën e disertacionit "Experimental Assessment of Central Hypersensitivity in Chronic Pain" (Përcaktimi eksperimental i tejdjeshmërisë qendrore të dhembja kronike), me mentor profesorin e njohur austriak Univ- Prof. Mag. Dr. phil. Peter Holzer, në Institutin e Farmakologjisë Eksperimentale dhe Klinikë të Universitetit Mjekësor të Grazit, Austri. Mësojmë se Albani është me prejardhje nga Peja dhe se ka diplomuar për mjekësi në Universitetin Mjekësor të Gracit, Austri. Rrjedh nga një familje akademike (nëna dhe i ati profesorë. Me të mbrojtur të temës nga Albani, babai Ymeri, nëna Manen dhe i vëllai Artani, që kishin ardhur nga Kosova, na deklaruan se ndjejnë një gëzim, kënaqësi e përjetim të veçantë, duke e përjetuar këtë edhe si triumf familjar e më gjerë, sepse çdo e arritur e shqiptarëve në mërgatë, ndonëse larg trungut amtar përjetohet si sukses i përbashkët.



GËZIM QË RRALLËHERË PËRJETOHET: ALBANI ME PRINDËRIT YMERIN E MANEN DHE TË SHOQEN RYVEN ME TË MBROJTUR TË DOKTORATURËS.



NË RRUGËTIM DREJT MAJAVE TË SHKENCËS: ALBANI I POSA DOKTORUAR, ME VALDET BERISHËN DOKTORANT NE UNIVERSITETIN E ST GALENIT.